

Ridvan Ibrahim, MA<sup>1</sup>

UDC: 341.171(4-672EY:497.7)  
330.34:341.171(4-672EY:497.7)

**ZHVILLIMI EKONOMIK I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT NGA PERSPEKTIVA EUROINTEGRUESE**

**ЕКОНОМСКИ РАЗВОЈ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА  
МАКЕДОНИЈА ОД ЕВРОИНТЕГРАЦИСКА ПЕРСПЕКТИВА**

**ECONOMIC DEVELOPMENT OF THE REPUBLIC OF NORTH  
MACEDONIA FROM THE EUROINTEGRATIVE PERSPECTIVE**

**Abstract**

Full membership in the European Union is still a strategic goal of the Republic of North Macedonia. Thus, the main priority is the start of negotiations for access to the European Union, as soon as possible, while on the basis of the achieved level of economic integration, adaptation of legislation and institutions, building good relations with neighbors and contributing to cooperation regional. Through the clearly established goal and clear aspiration for full integration into the European Union, the Republic of North Macedonia manifests its determination to build a society based on identical values as those of the Union - respect for human rights, democracy, rule of law and functional market economy. So, in December 1995, for the first time, the Republic of Macedonia established diplomatic relations with the European Union.

The Republic of North Macedonia, in this long and difficult journey, was forced to make 2 very important decisions, the first, the change of its name, as requested by Greece, as well as the placement of the Bulgarian people in the country's constitution. The first was successful, but not the second. So, at the meeting of the EU Council on June 18, 2019, in addition to noting the recommendation and gratitude for the reached Prespa Agreement, as well as the agreement with Bulgaria, it was concluded that the Council will return to the issue of enlargement with the aim reaching a clear and fundamental decision as quickly as possible.

***Keywords:*** *integration, economic development, agreement, market, etc...*

---

<sup>1</sup> PhD candidate - Economic institute, University St. Cyril and Methodius-Skopje

## 1. Aderimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut drejt Bashkimit Evropian

Anëtarësimi i plotë në Bashkimi Evropian edhe më tej paraqet qëllim strategjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kështu, prioritet kryesor është fillimi i negociatave për qasje në Bashkimi Evropian, sa më shpejt që është e mundur, ndërsa mbi bazën e shkallës së arritur të integritimit ekonomik, përshtatjes së legjislacionit dhe institucioneve, ndërtimi i marrëdhënieve të mira me fqinjët dhe kontributi në bashkëpunimin rajonal. Përmes qëllimit të qartë të vendosur dhe aspiratë e qartë për integrim të plotë në Bashkimi Evropian, Republika e Maqedonisë së Veriut e manifeston përcaktimin e vet të ndërtojë shoqëri të bazuar në vlera identike si ato të Unionit - respektimin e të drejtave të njeriut, demokraci, udhëheqje të drejtës dhe ekonomi funksionale të tregut. Në dhjetor të vitit 1995, e atëhershëmja Republika e Maqedonisë vendosi marrëdhënie diplomatike me Bashkimi Evropian, si shprehje e dëshirës të vendos bashkëpunim më të afërt politik dhe tregtar, por edhe si hap i parë drejt anëtarësimit të plotë për të cilin nga vetë fillimi i pavarësisë së vendit ishte arritur një konsensus i gjerë politik dhe shoqëror. Në prill të vitit 1997 u nënshkrua një Marrëveshje për bashkëpunim me të atëhershmin Komunitet Evropian, ndërsa në prill të vitit 2001 Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, e para e llojit të tillë. Marrëveshja, e cila i vendosi themelet për bashkëpunim të thelluar dhe strukturor në fusha të shumta, hyri në fuqi në vitin 2004. Një vit më vonë vendi mori statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimi Evropian, që hapi perspektiva të reja dhe horizonte në bashkëpunim, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në programet dhe politikat e përbashkëta të Unionit. Rekomandimi i parë për nisjen e negociatave për qasje në Bashkimi Evropian ishte dhënë në Raportin për progresin e vendit të publikuar në vitin 2009. Që atëherë, Komisioni Evropian në vazhdimësi rekomandon fillimin e negociatave të pranimit, por këto rekomandime nuk gjetën realizim në llojin e vendimit të Këshillit të BE-së për fillimin e negociatave. Më 26 qershor të vitin 2018, Këshilli i Bashkimit Evropian, rrjedhimisht në progresin e vendit dhe rekomandimet e Komisionit Evropian mori përfundime me të cilat hapet rruga për përcaktimin e datës për fillimin e negociatave të pranimit në qershor të vitit 2019. Njëkohësisht ishte miratuar zbatimi i fazës së parë nga procesi i skringut për qasje në Bashkimi Evropian, të a.q., skringing shpjegues<sup>2</sup>, përmes mbajtjes së takimeve në Bruksel për Kapitujt e veçantë nga legjislacioni evropian.<sup>3</sup>

Raporti pozitiv i Komisionit Evropian për vitin 2019 në tërësi i njeh arritjet e vendit në vitin e kaluar. Duke dhënë rekomandim të qartë për hapjen e negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut, Komisioni Evropian

<sup>2</sup> Explanatory screening

<sup>3</sup> <https://www.mfa.gov.mk/sq/page/6/anëtarësimi-në-be>

konstaton se vendi arriti progres themelor si në plan vendor, ashtu edhe në plan të jashtëm, në veçanti në ndërtimin e marrëdhënieve të mira me fqinjët.

Në takimin e Këshillit të BE-së të 18 qershorit 2019, përveç vënies në dukje të rekomandimit dhe mirënjohjes për Marrëveshjen e arritur të Prespës, si dhe marrëveshja me Bullgarinë, u konkludua se Këshilli do të kthehet në çështjen për zgjerimin me qëllim arritjen e një vendimi të qartë dhe themelor sa më shpejtë që është e mundur, ndërsa më së voni deri në tetor të vitit 2019. Përveç dinamikës së qartë të vërtetuar në këto vendime, Bashkimi Evropian në takimet në tetor 2019 nuk mundi të arrijë një konsensus për fillim të negociatave me Maqedoninë e Veriut. Maqedonia e Veriut për momentin e zbaton fazën e parë nga procesi i skringut për qasje në Bashkimin Evropian, të a.q., skringing shpjegues<sup>4</sup>, përmes mbajtjes së takimeve në Bruksel për Kapitujt e veçantë nga legjislacioni evropian. Në vitin 2018 Qeveria e miratoi Konceptin për strukturë negociuese, ndërsa në korrik të vitit 2019 e plotësoi kornizën e përgjithshme ligjore për formimin e të gjitha trupave të strukturave negociuese, si përgatitje për fillimin e negociatave për anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian.<sup>5</sup>

Korniza institucionale dhe legjislative për qasjen e vendit në Bashkimin Evropian është reflektuar në disa dokumente: Programi kombëtar për miratimin e ligjit të Unionit<sup>6</sup>, Programi kombëtar për reforma ekonomike<sup>7</sup> dhe Plani kombëtar për zhvillim<sup>8</sup> - dokumente, që rregullisht, në bazë vjetore, përshtaten në pajtim me rekomandimet nga Komisioni Evropian.<sup>9</sup>

## 2. Marrëdhëniet politike

Republika e Maqedonisë ishte vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit<sup>10</sup> me BE-në<sup>11</sup>, që hyri në fuqi në muajin prill të vitit 2004. MSA-ja synon të liberalizojë tregtinë për 95% të eksporteve me BE-në. Komisioni i Përbashkët Parlamentar u krijua në vitin 2004. Komisioni shqyrton të gjitha aspektet e marrëdhënieve midis BE-së dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut veçanërisht zbatimin e MSA-së. Në dhjetor të vitit 2005, vendit iu dha statusi vendit kandidat për anëtarësim në BE. Në dhjetor të vitit 2009, qytetarëve të vendit iu dha e drejta e udhëtimit pa viza në zonën Schengen. Në muajin mars të vitit 2020, Këshilli Evropian e

<sup>4</sup> Explanatory screening

<sup>5</sup> <https://www.mfa.gov.mk/sq/page/6/anëtarësimi-në-be>

<sup>6</sup> Ndryshime legjislative dhe masat për përforsim institucional në afat të shkurtër dhe të mesëm

<sup>7</sup> Masa për plotësimin e Kriteve ekonomike të Kopenhagës

<sup>8</sup> Prioriteti i investimeve për realizimin e qëllimeve zhvillimore të shtetit

<sup>9</sup> <https://www.mfa.gov.mk/sq/page/6/anëtarësimi-në-be>

<sup>10</sup> MSA

<sup>11</sup> Stabilisation and Association Agreement (SAA)

miratoi vendimin për hapje të negociatave me Maqedoninë e Veriut. Pasi Këshilli miratoi Kornizën Negociuese, në përputhje me Metodologjinë e reviduar të zgjerimit, më 19 korrik 2022, BE-ja filloi fazën e hapjes së negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut.<sup>12</sup>

### 3. Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare

BE-ja është partneri kryesor tregtar i Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë 77.5% të eksporteve të vendit dhe 51% të importeve të saj. Gjermania është partneri më i madh tregtar i vendit, ndjekur nga Britania e Madhe, Serbia, Kina dhe Greqia. Eksportet nga vendi përqendrohen në disa produkte, më të rëndësishmet janë: aliazhet e fero-nikelit, hekuri dhe çeliku, si dhe tekstili. Importet kryesore janë nafta bruto, energjia elektrike, produktet e petëzuara të hekurit dhe çeliku, si dhe automjetet. Disa nga programet dhe iniciativat kryesore të BE-së për të mbështetur rritjen e bizneseve dhe ekonominë më të gjerë janë në dispozicion për kompanitë me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përfshirë:<sup>13</sup>

- Horizon Europe 2021-2027<sup>14</sup>.
- Access2Markets<sup>15</sup>.
- Grow your Business<sup>16</sup>.
- Enterprise Europe Network<sup>17</sup>.

### 4. Ndihma e BE-së

Republika e Maqedonisë së Veriut dëshiron të bëhet anëtare e BE. Për ta ndihmuar në arritjen e këtij qëllimi, BE siguron mbështetje të vazhdueshme dhe ndihmë financiare nëpërmjet projekteve në mënyrë që vendi të mund të ndërmarë çdo reformë të nevojshme. Instrumenti për Para-Aderim<sup>18</sup> është instrumenti kryesor financiar i BE-së për të mbështetur reformat strukturore në Maqedoninë e Veriut dhe rrugën e vendit për aderim në BE. Që nga viti 2007, BE ka investuar 1.3 miliardë euro, nëpërmjet zarfit kombëtar IPA, në pesë fusha kryesore:<sup>19</sup>

<sup>12</sup> [https://www.eeas.europa.eu/republic-north-macedonia/bashkimi-europian-dhe-republika-e-maqedonise-se-veriut\\_sq?s=229](https://www.eeas.europa.eu/republic-north-macedonia/bashkimi-europian-dhe-republika-e-maqedonise-se-veriut_sq?s=229)

<sup>13</sup> [https://www.eeas.europa.eu/republic-north-macedonia/bashkimi-europian-dhe-republika-e-maqedonise-se-veriut\\_sq?s=229](https://www.eeas.europa.eu/republic-north-macedonia/bashkimi-europian-dhe-republika-e-maqedonise-se-veriut_sq?s=229)

<sup>14</sup> Programi kryesor i financimit të BE-së për kërkime dhe inovacione me një buxhet prej 95.5 miliardë €.

<sup>15</sup> Portal për eksportin dhe importin e BE-së, duke siguruar të gjitha tarifatat, procedurat doganore dhe formalitetet, kërkesat për produktet për EU market.

<sup>16</sup> Shërbime këshillëdhënëse të subvencionuara për kompanitë.

<sup>17</sup> Informacion dhe këshilla për kompanitë mbi çështjet e BE-së.

<sup>18</sup> IPA

<sup>19</sup> [https://www.eeas.europa.eu/republic-north-macedonia/bashkimi-europian-dhe-republika-e-maqedonise-se-veriut\\_sq?s=229](https://www.eeas.europa.eu/republic-north-macedonia/bashkimi-europian-dhe-republika-e-maqedonise-se-veriut_sq?s=229)

- **Sundimi i së drejtës dhe të drejtat themelore.**
- **Demokracia dhe qeverisja e mirë.**
- **Mbrojtja e mjedisit dhe lidhshmëria e qëndrueshme.**
- **Rritja ekonomike dhe kapitali njerëzor.**
- **Bujqësia dhe zhvillimi rural**

Republika e Maqedonisë së Veriut, gjithashtu ka përfituar edhe nga IPA Programi me Shumë-Përfitues, që shpërndau ndihmën e BE-së prej 2.98 miliardë € në 2014-2020 duke mbështetur projekte me ndikim rajonal për Ballkanin Perëndimor. Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor<sup>20</sup> mbështet Maqedoninë e Veriut në zbatimin e 23 projekteve në vlerë të përgjithshme prej 2.1 miliardë €. Investimet e BE të kanalizuar në Maqedoninë e Veriut arritën 163.2 milion € dhe mbulojnë asistencë teknike dhe punë investuese. Investimet e BE-së patën një efekt të rëndësishëm levave, duke sjellë në vend gjithsej 181.8 milionë në grante, dhe 580 milionë € në kredi preferenciale. Për më tepër, Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) ka siguruar 8.1 milion € për projekte që përmirësojnë demokracinë dhe të drejtat e njeriut në periudhën 2007-2020. Shkëmbimi i Asistencës Teknike dhe Informacionit<sup>21</sup>. BE-ja gjithashtu ofron mbështetje përmes Instrumentit TAIEX i cili i ndihmon vendet partnere të njihen, të aplikojnë dhe të zbatojnë ligjet e BE-së. TAIEX financon asistencë, këshillim dhe trajnim afatshkurtër teknik.

Asistenca e TAIEX është e hapur për:<sup>22</sup>

- **Punonjësit e administratës.**
- **Autoritetet e gjyqësorit dhe të zbatimit të ligjit.**
- **Organet parlamentare/legjislative dhe personelin e tyre.**
- **Shoqatat profesionale/tregtare, grupet e punonjësve dhe punëdhënësve.**
- **Përkthyesit dhe redaktorët e teksteve legjislative.**

Gjithashtu, Instrumenti TAIEX për Administratën Lokale<sup>23</sup> mbështet seminarët mbi politikat kyçe të BE-së të cilat tani kanë ndikim në nivel lokal për anëtarët e zgjedhur dhe zyrtarët e përhershëm të autoriteteve vendore dhe rajonale.

<sup>20</sup> WBIF

<sup>21</sup> TAIEX

<sup>22</sup> [https://www.eeas.europa.eu/republic-north-macedonia/bashkimi-europian-dhe-republika-e-maqedonise-se-veriut\\_sq?s=229](https://www.eeas.europa.eu/republic-north-macedonia/bashkimi-europian-dhe-republika-e-maqedonise-se-veriut_sq?s=229)

<sup>23</sup> LAF

## 5. Përmbushja e kriterëve ekonomike për anëtarësim të R. së Maqedonisë së Veriut në BE

Republika e Maqedonisë së Veriut i ndanë të gjitha avantazhet dhe obligimet që dalin pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Agjendës së Selanikut nga viti 2003 që njëherit paraqet kornizën e politikës së BE për Ballkanin Perëndimor. Bashkimi Evropian vazhdon të zbaton kriterë të ashpra drejt vendeve kandidat duke zbatuar kushtëzime të ashpra të përparimit të vendit në aspekt ekonomik dhe politik.<sup>24</sup>

Komisioni Evropian nga marsi i vitit 2002 dorëzon rregullisht raport gjer të Këshilli dhe Parlamenti Evropian për përparimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky raport përfshinë periudhën nga 1 tetori i vitit 2007 gjer në fillim të tetorit të vitit 2008. Kriteret ekonomike konform raportit janë:<sup>25</sup>

### a) Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut

- Bazat e politikës ekonomike
- Stabiliteti makroekonomik
- Veprimi i lirë i forcave të tregut
- Hyrje dhe dalje të lirë në treg
- Sistemi adekuat juridik
- Niveli zhvillimor i mjaftueshëm i sektorit financiar

### b) Kapaciteti për ballafaqim me presionet konkurruese të tregjeve

- Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut
- Kapitali i mjaftueshëm human dhe fizik
- Struktura adekuate sektoriale dhe e kompanive
- Ndikimi i shtetit mbi konkurrencën
- Integrimi tregtar me BE

Funksionalitetin e ekonomisë së tregut në R. e Maqedonisë së Veriut do ta prezantojmë duke shprehur karakteristikat përkatëse të: Bazës politike të ekonomisë, Stabilitetin makroekonomik, Veprimin e lirë të forcave të tregut, Hyrjen dhe daljen e lirë nga tregu, Sistemin adekuat juridik, Zhvillimin e sektorit financiar konform raportit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

<sup>24</sup> Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) "Perspektivat Euro-Atlantike të RM-së: Problemet, sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukuresht 2008" (Hulumtim mbi politikën aktuale dhe opinionin e qytetarëve) - Referate të prezentuara në Konferencën shkencore të mbajtur në UEJL më datë 2 Maj 2009 - Projekt i financuar nga UEJL dhe i mbështetur nga Komiteti Akademik për hulumtime, Tetovë 2009, f.63

<sup>25</sup> Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) "Perspektivat Euro-Atlantike të RM-së: Problemet, sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukuresht 2008" (Hulumtim mbi politikën aktuale dhe opinionin e qytetarëve) - Referate të prezentuara në Konferencën shkencore të mbajtur në UEJL më datë 2 Maj 2009 - Projekt i financuar nga UEJL dhe i mbështetur nga Komiteti Akademik për hulumtime, Tetovë 2009, f.71

Stabiliteti makroekonomik është një parakusht me shumë rëndësi për realizimin e një rrite të qëndrueshme ekonomike<sup>26</sup>, Stabiliteti makroekonomik definohet nga ekspertët e Bankës Botërore se është arritur në ato raste kur inflacioni është nën kontroll, kur borxhi i brendshëm dhe i jashtëm menaxhohen me sukses dhe kur krizat e paraqitura makroekonomike tejkalohen në kuadër të një ose dy viteve<sup>27</sup>, Kuptimi më i gjerë teorik i stabilitetit makroekonomik nënkupton jo vetëm realizimin e normave të ulëta të inflacionit dhe të deficitit buxhetor por edhe nivele të kënaqshme të rritës ekonomike dhe norma të ulëta të papunësisë.<sup>28</sup>

Nëse do të analizonim biznes klimën e Maqedonisë duke e krahasuar atë me ekonomitë e rajonit<sup>29</sup> mund të konstatojmë se ka avantazh krahasimor me to. Ajo është e ranguar më mirë se vendet e analizuara përveç Bullgarisë. Nëse do të analizonim shkallën e korrupsionit në vend sipas *Corruption Perceptions Index* 2008 me plotë të drejtë mund të konstatojmë se kemi një përmirësim të dukshëm por jo të mjaftueshëm. Krahasuar me vendet e regjionit RM-së në vitin 2009 ka disavantazh vetëm nga Kroacia (HR) dhe nivel të njëjtë me vendin anëtarë të BE-Bullgarinë, ndërsa me vendet tjera të krahasuara ka avantazh të theksuar. (Shikoni tabelën - Korrupsioni).<sup>30</sup>

Ekonomia (Rang)	Të bësh biznes				Korrupsioni			
	2008	2007	2006	2005	2008	2007	2006	2005
ALB	86	135	120	115	85	105	111	126
BH	119	117	95	91	92	84	93	88
BUL	45	44	54	59	72	64	57	55
HR	106	107	124	134	62	64	69	70
MKD	<b>71</b>	<b>79</b>	<b>92</b>	<b>94</b>	<b>72</b>	<b>84</b>	<b>105</b>	<b>103</b>
MZ	90	84	70	64	85	84	90	97
SR	94	91	68	95	85	79	90	97

<sup>26</sup> FMN 2001

<sup>27</sup> IBRD 1993

<sup>28</sup> Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) "Perspektivat Euro-Atlantike të RM-së: Problemet, sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukuresht 2008 (hulumtim mbi politikën aktuale dhe opinionin e qytetarëve) - Referate të prezentuara në Konferencën shkencore të mbajtur në UEJL më datë 2 Maj 2009- Projekt i financuar nga UEJL dhe i mbështetur nga Komiteti Akademik për hulumtime, Tetovë 2009, f.71-72

<sup>29</sup> Sipas raportit të Doing Business

<sup>30</sup> Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) "Perspektivat Euro-Atlantike të RM-së: Problemet, sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukuresht 2008 (hulumtim mbi politikën aktuale dhe opinionin e qytetarëve) - Referate të prezentuara në Konferencën shkencore të mbajtur në UEJL më datë 2 Maj 2009- Projekt i financuar nga UEJL dhe i mbështetur nga Komiteti Akademik për hulumtime, Tetovë 2009, f.75

Analizimi i kapacitetit të ekonomisë së vendit kundrejt presioneve konkurruese të tregjeve të BE do të realizohet duke përcjellë karakteristikat e veçanta për: Ekzistimin e ekonomisë funksional të tregut, Kapitalin e mjaftueshëm fizik dhe njerëzor, Strukturën sektoriale dhe strukturën e kompanive, Ndikimin e shtetit mbi konkurrencën, Integrimin tregtar në BE.<sup>31</sup>

### **Conclusions**

European integration has always presented a political process and economic, which is open to all European states willing to sign the founding agreements and fully accept the European legislation. According to the Treaty of Rome, any European country can apply to become a member of the Community. In 1993, at the request of the former communist states to join the EC, the European Council presented three conditions that they must fulfill in order to join. These conditions were recognized as the Copenhagen criteria.

The Copenhagen criteria are the main principles according to which functions of the EU, respectively, on the other hand, the main conditions that must be fulfilled by every state that claims to become a member of the EU.

This includes the rule of law, freedom of expression, freedom of movement, etc. As long as the new members enter the EU, as a first condition they must have stable institutions that guarantee democracy, the rule of law, human rights and the protection of minorities.

The second condition is the functional market economy as well as the capacity to deal with the suppression of market forces in the EU.

The third condition is the ability to undertake obligations from membership, including supporting EU objectives.

### **Recensentë:**

**Prof. dr. Seadin Xhaferi**

**Prof. dr. Neritan Turkeshi**

---

<sup>31</sup> Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) “Perspektivat Euro-Atlantike të RM-së: Problemet, sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukuresht 200Hhulumtim mbi politikën aktuale dhe opinionin e qytetarëve) - Referate të prezentuara në Konferencën shkencore të mbajtur në UEJL më datë 2 Maj 2009- Projekt i financuar nga UEJL dhe i mbështetur nga Komiteti Akademik për hulumtime, Tetovë 2009, f.77



### Literatura

- [https://www.eeas.europa.eu/republic-north-macedonia/bashkimi-european-dhe-republika-e-maqedonise-se-veriut\\_sq?s=229](https://www.eeas.europa.eu/republic-north-macedonia/bashkimi-european-dhe-republika-e-maqedonise-se-veriut_sq?s=229)
- <https://www.mfa.gov.mk/sq/page/6/anëtarësimi-në-be>
- <https://www.sep.gov.mk/sq/post/?id=17>
- <https://www.sobranie.mk/unioni-european.nspх>
- Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) “Perspektivat Euro-Atlantike të RM-së: Problemet, sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukuresht 2009 (Hulumtim mbi politikën aktuale dhe opinionin e qytetarëve) - Referate të prezentuara në Konferencën shkencore të mbajtur në UEJL më datë 2 Maj 2009- Projekt i financuar nga UEJL dhe i mbështetur nga Komiteti Akademik për hulumtime, Tetovë 2009.
- Закон за ратификација на спогодбата за стабилизација и асоцијација меѓу Република Македонија и Европските заедници и нејзините земји членки, Службен весник на Република Македонија-Меѓународни договори бр.28 од 13 април 2001 година.